Project: Date ...... /...... / ....66..

# Protokoll Nr. 4

Ky protokoll mbahet sot më datë 24.4.2026, ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të KB Divjakë, kati i dytë, në godinën e Bashkisë Divjakë, për zhvillimin e mbledhjes së radhës së Këshillit të Bashkisë, për muajin Prill 2024.

Në mbledhje marin pjesë këshilltorët:

Liri Biti, Njazi Balli, Donika Stasa, Alketa Canaku
Juljan Vrapi, Shpëtim Sheshi,
Elmenina Sina, Xhorxhi Icrali, Ajete Mebelli
Jurgen Shuli, Roza Troshku,
Ardjon Shurdhagi, Majlinda Xharo,
Mishel Vendha, Antuela Gjini,
Lili Biti.

Meqenëse u plotësua kuorumi për zhvillimin e mbledhjes, Sekretarja e Këshillit znj. Liri Biti e deklaron mbledhjen të hapur.

Kalon në rendin e ditës:

Rendi i ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 30.03.2026.
3. Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Mars 2026.
4. Projekt vendim për miratimin e faturave që do të trajto-hen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Mars 2026
5. Projekt vendim për një ndryshim në VKB nr 90 dt. 29.12.2025 për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë institucioneve në varësi dhe Nj. Adm. për vitin 2026.
6. Projekt vendim për krijimin e Këshillit vendor të sigurisë publike në Bashkinë Divjakë dhe miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij.
7. Projekt vendim për transferimin e Asetit " Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Nj. Adm. Remas " për Shoqërinë Rajonale të UK Lushnjë sh.a.
8. Projekt vendim për një ndryshim në pozicionin e fushave sportive për projektin " Rikonstruksion i objekteve ekzis-tuese, sallës ndihmëse dhe ndërtim palestre në ShM Bashkuar Remas, Bashkia Divjakë
9. Raport mbi veprimtarinë e KB. Divjakë për vitin 2025.
10. Raport mbi transparencën në Vendimmarrje të KB për v. 2025.

Project: Date ...... /...... / ..........

1. Pika e parë e Rendit të ditës.
- Miratimi i Rendit të ditës.
Kryetarja znj. Liri Bitri i drejtohet këshilltarëve: A keni pyetje, shtesa, pakësime për rendin e ditës.
Pyetje nga këshilltarët nuk ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës dhe votohet me 16 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
2. Pika e dytë e rendit të ditës.
- Miratim i procesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 30.3.2026.
Kryetarja znj. Liri Bitri: Procesverbalin e keni lexuar, a keni pyetje apo diskutime rreth Procesverbalit!
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 16 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
3. Pika e tretë e rendit të ditës
- Informacion mbi zbatimin e vendimeve të KB për m. Mars 2026
Për informacionin nuk ka pyetje, nuk ka diskutime dhe Kryetarja kalon tek leximi i Raporteve të komisioneve për shqyrtimin e projektvendimeve për kalimin për miratim në mbledhje.
Kryetarja znj. Liri Bitri ia jep fjalën znj. Roza Troshku për leximin e raportit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financës. Znj. Roza Troshku shprehet: Komisioni i Ek dhe Financ. u mblodh më datë 21.4.2026 dhe pasi mori në shqyrtim projektvendimet e paraqitura nga Bashkia vendosi që projektvendimet Nr 36, 37, 39 të kalojnë për miratim në këtë mbledhje. Projektvendimet u votuan nga anëtarët e komisionit me 4 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abst.
znj. Liri Bitri ia jep fjalën Kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes dhe emergjencave z. Shpëtim Shestri i cili shprehet: Komisioni i Mbrojtjes dhe emergjencave civile u mblodh më datë 23.4.2026 dhe pasi shqyrtoi Projektvendimin nr 38 datë 15.4.2026 vendosi që të kalojë për miratim në mbledhje. Projektvendimi u votua nga anëtarët e komisionit me 4 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
Pas Kryetarit të komisionit të Mbrojtjes dhe emergjencave civile

për Komisionin e Urbanistikës, lexoi Raportin znj. Antuela Gjini.
Komisioni i Urbanistikës, u mblodh më datë 22.4.2026 dhe pasi mori në shqyrtim Projektvendimin Nr. 40 datë 16.4.2026 vendosi të kalojë për miratim në mbledhje.
Sekretarja znj. Lirie Bili: Kalojmë në.

4. Pika e katërt e rendit të ditës.
- Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6%, për muajin Mars 2026.
Për këtë pikë relaton Përgjegjësi i Sektorit të nd. ekonomike z. Dedio Muço, ku për muajin Mars, Bashkia ka 13 familje në nevojë, të dala nga sistemi i pikëzimit nga pikët e mjaftueshme, kanë aplikuar, dhe pasi u është bërë dhe verifikimi në familje, propozojmë që të trajtohen me ndihmë ekonomike me fond deri 6%, të fondit të kushtëzuar për m. Mars, me një fond prej 63.223 lekë. Këto familje janë: Elisabeta Zai 10692 lekë, Afërdita Lupi 5940 lekë, Esmeralda Gjata 7920 lekë, Vitrina Sula 5940 lekë, Ymer Albajrami 1525 lekë, Alketa Meta 5227 lekë, Mimoza Krasniqi 2178 lekë, Bashime Gjini 1525 lekë, Zeqir Zeqiri 3703 lekë, Neim Dose 5227 lekë, Suzana Muça 5940 lekë, Bardhul Çarko 3703 lekë, Klodiana Ndoni 3703 lekë.
Pyetje nga këshilltarët për këtë pikë s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e katërt e rendit të ditës dhe votohet me 16 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

5. Pika e pestë e rendit të ditës
- Për një ndryshim në VKB nr 90 dt. 29.12.2025 "Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë, inst. në varësi dhe Nj. Adm. për vitin 2026.
Relaton për këtë pikë specialistja e pagave pranë drejtorisë së financës dhe Buxhetit znj. Amarilda Sina, ku i propozon këshilltarëve të miratojnë ndryshimin e VKB nr 90 dt. 29.12.2025, ku ky ndryshim konsiston në indeksimin e rritjes së pagave për punonjësit e transfertave të pakushtëzuara sektoriale: Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe Shpëtimi, Arsimi parashkollor, Sektori i Ujitjes dhe Kullimit dhe Sektorit të Pyjeve.
Pyetje nga këshilltarët s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e pestë e rendit të ditës dhe votohet me 16 votë pro, asnjë votë kundër asnjë votë abstenim.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Project: Date ...... /...... / ...........

-Për krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Divjakë dhe miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e tij.
Sekretarja zj. Xin Bizi ia jep fjalën për relatim Juristit z. Andi Bullon, ku ky i fundit i propozon këshilltarëve të miratojnë krijimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike (KVSP) në Bashkinë Divjakë, si dhe të miratojnë Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e tij. Rregullorja e KVSP është bashkëlidhur projekt vendimit dhe relacionit përkatës.
Pyetje: z. Ardjan Shurdhagi: Ky komision a ka buxhet? Shikoj se të gjithë antarët e këtij këshilli janë të punësuar.
Përgjigjet z. Andi Bullon: Jo nuk ka probleme financiare, nuk ka fonde për mbarëvajtjen e këtij këshilli.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 16 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
7. Pika e shtatë e rendit të ditës:
- Për transferimin e asetit "Furnizimi me ujë për zonat bregdetore të Bashkisë Divjakë dhe Nj. Adm. Remas, në shoqërinë rajonale të UK Lushnje sh.a.
Sekretarja zj. Xin Bizi ia jep fjalën për relatim Sekretares së Përgjithshme zj. Kleuisa Arudha, e cila i propozon këshilltarëve: të miratojnë transferimin e asetit "Furnizimi me ujë për zonat bregdetore të Bashkisë Divjakë dhe Nj. Adm. Remas, Lodi, në Shoq. Rajonale të UK Lushnje ShA. investimi i cili është marrë në dorëzim përfundimtar sipas certifikatës nr 607 dt. 23.1.2026.
-Vlera e investimit sipas situacionit përfundimtar është 496 124 988 lekë, -Vlera e mbikqyrjes së punimeve është 4 301 243 lekë pa TVSh.
Pyetje: z. Njazi Balla: Mbledhja e të ardhurave nga faturimi i ujit, a e justifikon gjithë këtë investim. Kush do ta bëjë faturimin e ujit? Përgjigjet zj. Kleuisa Arudha: Me të marrë Vendimin, faturimi do të kryhet nga UK Lushnje sh.a, të gjitha shërbimet e defektet do të përballohet nga Ministria e Infrastrukturës e cila ia adreson UKZ Lushnje.
Diskuton z. Ardjan Shurdhagi: Ky është Vendim qeverie e cila e ka decentralizuar komplet në tërë Republikën dhe e ka kthyer në subjekte të përbashkëta. Unë nuk kam qenë dakort, edhe në Vendimin marrjen e parë për bashkimin

e ngjesjellsave. Por ky është Vendim i KM, dhe qeveria
nuk i jep fonde Bashkive për administrimin e tyre, gjë që
të gjitha shkelimet dhe difektet Bashkia nuk i përballon
dot. Unë votoj kundër për këtë projekt vendim.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës dhe votohet me
12 vota pro, 4 vota kundër, dhe asnjë votë abstenim.
Kryetarja znj. Lin Biti: Ky projektvendim nuk miratohet.

8. Pika e tetë e rendit të ditës
- Për një ndryshim në pozicionin e fushave sportive për
projektin "Rikonstruksion i objekteve ekzistuese, shtesë anësore
dhe ndërtim palestre në SHMB Remas - B. Divjakë.
Për këtë pikë relaton z. Ardit Janko, Drejtor i Pl. Zhv. Territorit,
ku i propozon Këshilltarëve që të miratojnë një ndryshim në
pozicionin e fushave sportive për projektin "Rikonstruksion i
objekteve ekzistuese, shtesë anësore dhe nd. palestre në ShKM Remas.
sepse është konstatuar mungesë në projektin fillestar, dhe problematik
është terreni jo i qëndrueshëm, ku rrezikohet cedimi i strukturës
për nd. e palestrës. z. Ardjan Shurdhaq: Ky projekt ka një vjet
që ka filluar, akoma s'ka informuar, pse nuk e keni kërkuar më
përpara? Përgjigjet z. A. Janko: Për mungesë Arkitekti se nuk kemi
në Bashki. Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka. Hidhet në votim
pika e tetë e rendit të ditës dhe votohet me 16 vota pro, asnjë
votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

9. Pika e nëntë e rendit të ditës.
- Raport mbi veprimtarinë e KB Divjakë për vitin 2025.
Kryetarja znj. Lin Biti: A kemi pyetje apo diskutime? Pyetje
s'ka, diskutime s'ka. Hidhet në votim pika e nëntë e
rendit të ditës dhe votohet me 16 vota pro, asnjë
votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

10. Pika e dhjetë e rendit të ditës.
- Raport mbi transparencën në Vendimmarrje të KB. Divjakë
për vitin 2025.
Pyetje nga këshilltarët për pikën e 10, nuk ka, diskutime
s'ka. Hidhet në votim pika e dhjetë e rendit të ditës
dhe votohet me 16 vota pro, asnjë votë kundër dhe
asnjë votë abstenim.
Kalohet në zërin "Të tjera".
Kryetarja znj. Lin Biti: A kemi pyetje për pikën të tjera?

Project: Date ...... /...... / ...........

zj. Alketa Ceneku ngre problemin për një invalid që ka nevojë për një karrocë.
Përgjigjet Përgjegjësi i Sekt. nd. ekonomike z. Dedio Muço: Është marrë në shqyrtim kjo kërkesë, sepse është rast i veçantë, dhe këtë e kemi në vorhdimësi, jemi në kërkim dhe do lidhemi me donator e shoqata të ndryshme ndihmëse.
zj. Majlinda Xhoro: Ngre problematikën për çmimin e Biletës së urbanit Divjak - Pashtim, shoferi ngo 50 lekë tani merr 100 lek. Përgjigjet z. A. Bullari: Do ta verifikojmë.
Kryetarja e deklaron mbledhjen e KB, m. Prill të mbyllur.
Sekretari i KeB.
Mimoza Gjomaj

Kryetare e Këshillit,
Liri Beta

Mazë Balla

Ardjan Jemallaj

Alketa Ceneku

Roza Troshku

Juljan Vrapi

Shpëtim Gherëni

Gjete Mefelli

Antuela Gjini

Majlinda Xharo

Jurgen Shala

Elmaz Gina

Donika Stasa